Co-PLAN GAZETTE

Publikim Gjashtëmujor i Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Publikim Gjashtëmujor Gazette No. 4 - Janar 2013

2012 në Objektiv

Ngjarjet më të spikatura të vitit, studime, dhe zhvillime të rëndësishme në agjendën kombëtare gjatë vitit 2012, veçanërisht në lidhje me diskutimin e decentralizimit fiskal, zhvillimin rajonal, Javët e Arkitekturës në Tiranë, si dhe Ndikimi në Politikëbërje.



© Kjo gazetë, përfshirë dhe imazhet nuk mund të riprodhohen , pjesërisht apo tërësisht, pa pëlqimin e autorëve dhe Co-PLAN.

Fakte & Gjetje

Me rëndësi nga Planifikimi i Territorit në Shqipëri

- Ligji "Për Planifikimin e Territorit" dhe aktet nënligjore të njëpasnjëshme përbëjnë një përpjekje të rëndësishme për të adresuar hendekun mes Zhvillimit të territorit të udhëhequr nga njerëzit dhe reagimit ligjor dhe institucional të Qeverisë për ta drejtuar këtë zhvillim. Ende mbetet në pikëpyetje, nëse kjo reformë do të jetë e suksesshme.
- Ligji i ri është shumë kompleks për përdoruesit dhe kërkon investime të mëdha në kapacitete, si edhe një ndryshim në mentalitet se si instrumentet e zhvillimit të tokës mund të financojnë infrastrukturën publike.
- Të drejtat e Zhvillimit i përkasin institucioneve qeverisëse dhe procesi planifikimit duhet t'i shpërndajë këto të drejta në mënyrë efektive për të garantuar Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit .Qeveria duhet të marrë një rol drejtues në zhvillimin territorial, në mënyrë që të garantojë një balancim më të mirë të interesave publike dhe private për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Ligji Planifikimit të territorit mund të marrë kohë për të t'u integruar në sistemin ligjor Shqiptar.

  Më shumë se 80 ligje duhet të rishikohen për tu përputhur me ligjin e planifikimit të territorit.
- Nuk ka decentralizim të plotë në planifikimin e territorit. Planifikimi urban përbën një kompetencë lokale, por është i ndarë mes pushtetit vendor dhe atij qendror.
- Ka mungesë besimi nga qytetarët për zhvillimin gjithëpërfshirës të planifikimit të territorit. Bashkitë duhet të jenë kreative për të përfshirë qytetarët në proceset e planifikimit dhe të sigurojnë rezultatet e prekshme nga kjo pjesëmarrjeje. Ndikimi i politikave të BE-së në planifikimin e territorit nuk është matur dhe ndikimi i tërë reformës nuk u vlerësua para hartimit të ligjit .

Akte Nënligjore siç përcaktohen nga Ligji 'Për Planifikimin e Territorit'	Statusi i Miratimit
Ligji 'Për Planifikimin e Territorit'	Nr. 10119, datë 23.04.2009; Hyrë në fuqi më: 30.09.2011; Ndryshuar me: Ligji nr. 10258, datë 25.03.2010; Akti Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 25.08.2010; Ligji nr. 10360, datë 16.12.2012.
1. AKPT	VKM nr. 1190, datë 13.11.2009, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit"
2. KKT	VKM nr. 87, datë 7.2.2012, "Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit". VKM-ja mbi rregullimin e KKT-së është rishikuar dhe është në pritje të aprovimit nga Këshilli i Ministrave.
3. Rregullorja Uniform e Instrumentave të Planifikimit	VKM nr. 481, datë 22.06.2011, "Për Miratimin e Rregullores Uniform të Instrumentave të Planifikimit".
4.. Rregullorja Model e Planifikimit	VKM nr. 480, datë 22.06.2011, "Për Aprovimin e *Rregullores Model të Planifikimit*; Ndryshuar me: VKM nr. 140, datë 22.02.2012
5. Rregullorja e Ndërtimit	Procesi i hartimit nuk ka filluar.
6. Regjistri i Planifikimit të Territorit	VKM nr. 460, datë 16.06.2010, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Regjistrit të Planifikimit të Territorit" VKM nr. 459, datë 16.06.2010, "Për Miratimin e standarteve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS."
7. Rregullorja Uniform e Kontrollit të Zhvillimit	VKM nr. 502, datë 13.07.2011, "Për miratimin e *Rregullores Uniform të Kontrollit të* Zhvillimit"; Ndryshuar me: VKM nr. 88, datë 7.02.2012; VKM nr. 139, datë 22.02.2012; VKM nr. 345, datë 9.05.2012.
8. Instrumente të veçanta për Kontrollin e Zhvilimit (Akte Nënligjore për Zbatim)	Nuk ka filluar ndonjë proces specifik hartimi.
9. Struktura Uniforme e Raportit Vjetor mbi Zhvillimin e Territorit.	Drafti i përgatitur në Qershor 2012 , pas komenteve nga Ministritë e linjës, rishikuar në Tetor 2012, në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave.
*10. Plani i P*ërgjithshëm Kombëtar i Territorit	Pritet të fillojë së shpejti.

Gjendja e Rajonalizimit në Shqipëri

Progresi dhe Sfidat Përpara







"Pas 12 vitesh pune intensive mbi decentralizimin për nivelin e parë të qeverisë, kjo tryezë kishte për qëllim të drejtonte vëmendjen drejt progresit dhe sfidave që janë ende përpara për rajonalizimin në Shqipëri."

Një tryezë ndërkombëtare është organizua nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë Veriore në kuadër të Kryesisë së Komitetit të Ministrave të Këshillave të Evropë. Qëllimi i këtij takimi ishte të mblidhte rreth tryezës së diskutimit grupe interesi për të sjellë propozime dhe për të ushqyer një debat të shëndetshëm mbi rajonalizimin e Shqipërisë. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të çuar përpara çështjet e zhvillimit rajonal dhe rajonalizimin, ka ende pyetje që mbeten të paqarta. Qëllimi i kësaj tryeze ishte që të trajtonte këto çështje përmes një debati mes ekspertësh duke përgatitur një listë me hapat kryesorë për t'u ndërmarrë nga Qeveria Shqipëtare gjatë dialogut politik dhe vendim-marrjes.

(1) Aktualisht Qarku ka një rol relativisht të vogël në qeverisje vendore krahasuar me bashkitë dhe komunat, por mund të ketë një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe koordinimin zhvillimit rajonal nga lart – poshtë . A do mbetet Qarku me të njëjtat funksione dhe kufij territorial, apo do të caktohet një rajon i ri?

(2) Nëse do përcaktohen rajone të reja, cili mund të jetë lloji i preferuar i rajonalizimit që mund të bëhet në Shqipëri për të përmbushur nevojat e brendshme në zhvillimin ekonomik dhe në decentralizim?

(3) Si duhet të lidhë Shqipëria zhvillimin e brendshëm rajonal me zhvillimin rajonal të BE-së dhe politikat e kohezionit?

(4)Cilat do të jenë implikimet institucionale, ligjore dhe politike të çdo reforme në zhvillimin rajonal dhe rajonalizimin në Shqipëri?

(5) Si do të ndërveprojnë [në mënyrë reciproke] përpjekjet për rajonalizimin dhe zhvillimin rajonal me procesin e integrimit ne Europë.

Për të mundësuar adresimin dhe përgjigjen e këtyre pyetje, tryeza e rrumbullakët e cila u kryesua nga Z/Ministri i Punëve të Brendshme z Ferdinand Poni, u fokusua në katër temave kryesore

Tema 1: "Sfidat e decentralizimit dhe rajonalizimit të Shqipërisë" nga perspektiva e Kongresit të Autoriteteve Vendore (Z.Andreas Kiefer, Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit).

Tema 2: Statusi i "rajonit" dhe mundësitë për përmirësim (Z.Besnik Aliaj).

Tema 3: Roli i "rajonit" në kontekstin e Integrimit Evropian (Znj.Grida Duma).


Tema 4: E ardhmja e Zhvillimit Rajonal dhe e institucioneve të lidhura me të në Shqipëri (Z.Daniel Wagner).

Pas 12 vitesh pune intensive mbi decentralizimin për nivelin e parë të qeverisë, kjo konferencë kishte për qëllim të drejtonte vëmendjen drejt progresit dhe sfidave që janë ende përpara për rajonalizimin në Shqipëri.

Decentralizimi & Demokracia

Roli i decentralizimit në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri dhe Integrimi Europian.

Me rastin e Kryesimit Shqipëtar të Këshillit të Europës, Ministria e Brendshme organizoi në datat 30-31 tetor, 2012, një konferencë ndërkombëtare.



Kjo ishte mbyllja dhe ngjarja më e rëndësishme e organizuar nën Kryesinë tonë, me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës Z. Bujar Nishani, Kryeministrit të Shqipërisë Z.Sali Berisha, Ministrit të Brendshëm Z. Flamur Noka, Kryetares së Kuvendit Znj. Jozefina Topalli, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës Z. Lulzim Basha, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës Z.Thorbjorn Jagland, Ambasadori i Delegacionit Europian Z. Ettore Seqqui BE, Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit të Autoriteteve Europiane vendore dhe rajonale Z. Andreas Kiefer, Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri Z.Eugen Wollfarth dhe përfaqësues të tjerë të ministrive, delegacioneve ndërkombëtare, qeverive vendore dhe rajonale, organizatave dhe shoqërisë civile. Konferenca ishte në përputhje me kontributet e politikave të Shqipërisë gjatë kryesimit: Promovimi i të drejtave të njeriut në nivel qeverie vendore; pjesëmarrje qytetare në nivel qeverie vendore dhe rajonale; konsolidimi i rajonalizimit në Shqipëri, forcimi i rolit të këshilltarëve vendorë dhe rajonal në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe modernizimi i administrimit. Objektivi i konsolidimit të rajonalizimit dhe procesi i zhvillimit rajonal në Shqipëri u diskutuan gjerësisht në takim ,sidomos tema e parë, e tretë dhe tema e gjashtë.Tema e parë e fokusuar veçanërisht në "Konsolidimin e Rajonalizimit" me diskutimet mbi sfidat rajonet shqiptare dhe rolet, procesin e rajonalizimit në kuadër të anëtarësimit në BE dhe perspektiva e zhvillimit rajonal në Shqipëri. Gjithashtu Co-PLAN dha një kontribut përmes prezantimit të Z. Dritan Shutina, Drejtor Ekzekutiv, mbi kuadrin e përgjithshëm të rajonalizimit në Shqipëri dhe konsolidimin e mëtejshëm të rolit të rajoneve shqiptare, së bashku me sfidat dhe tendencat. Tema e tretë u përqendrua në bashkëpunimin multilevel dhe rëndësinë e tij në tejkalimin e pengesave të veçanta trans-kufitare, me vëmendje të veçantë të fondeve IPA. Tema gjashtë mundësoi kontribut të konsiderueshëm në instrumentet dhe praktikat për zhvillimin rajonal, duke u fokusuar sidomos në rolin e Agjencive Rajonale për Zhvillim.

Iniciativat më të fundit në Planifikimin e Territorit

Trajnim i Bashkive për Rishikimin e Planeve Territoriale.






Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit (AKPT), në përputhje me detyrimin e saj ligjor për të lehtësuar proceset e planifikimit, ka organizuar një proces trajnimi me 10 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) duke u përqëndruar në shqyrtimin e planeve të përgjithshme të këtyre njësive territoriale vendore duke i përshtatur me specifikimet e Ligjit, datë 23.04.2009 nr. 10119, "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Procesi i shqyrtimit, i cili u zhvillua nga muaji prill deri në tetor 2012, u financua nga USAID në kuadër të Projektit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore (2012-2016 PLGP) dhe u mbështet teknikisht nga ky projekt. Bashkitë të cilat morën pjesë në program ishin ato të Shkodrës, Beratit, Korçës, Fushë-Krujës, Kamzës, Fierit, Gjirokastrës, Vlorës, Pogradecit dhe Durrësit. Gjatë këtij programi trajnimi, u organizuan pesë sesione asistuese, ku specialistë nga bashkitë u këshilluan mbi teknikalitetet nga pesëmbëdhjetë specialistë të Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit (AKPT) dhe pesë konsulentëve të jashtëm (PLGP) nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Këto sesione trajnuese dhanë njohuri të shumta mbi pesë komponentet kryesore që do të ndihmojnë për të kuptuar kërkesat që këto plane, politika të përaferta, rregulloret dhe dokumentet e tjera të nevojshme ligjërisht do duhet të përmbushen në mënyrë që të jenë në përputhje me kuadrin e ri ligjor. Roli i AKPT-së dhe i konsulentëve të jashtëm ishte thjesht këshillues dhe planet janë përshtatur direkt nga specialistët e NJQV-ve pjesëmarrëse.

Në fund të seancave trajnuese, planet e rishikuara u miratuan nga këshillat përkatës të bashkive të Shkodrës, Beratit, Korçës, Fushë-Krujës, Kamzës, Fierit, Gjirokastrës, Vlorës, Pogradecit dhe Durrësit. Bashkitë e Shkodrës, Beratit, Fushë-Krujës, Fierit, Durrësit etj ju dorëzuan AKPT-së për të filluar procesin e miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Për të festuar mbylljen e suksesshëm të këtij procesi trajnimi , në datën 14 Nëntor 2012, u organizua "Takimi Kombëtar për Fuqizimin e Autoriteteve Lokale në Planifikimit e Territorit dhe Procesit të Administrimit", ku ishin ftuar Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Z. Sali Berisha, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Z.Alexander Arvizu., Drejtori i Projektit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore (PLGP) në Shqipëri Z. Peter Clavelle, ekspertë të PLGP-së, drejtorë të AKPT-së dhe ekspertë, kryetarët e bashkive dhe drejtorët e planifikimit të NJQV-ve pjesëmarrëse, të mbështetur nga nga PLGP në këtë proces, donatorë, OJQ, përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë. Ky takim kishte për qëllim të paraqiste punën e ndërmarrë deri më tani për zbatimin e reformave në sektorin e planifikimit të territorit, duke u fokusuar në programin e AKPT dhe PLGP trajnimeve për rishikimin e planeve, si dhe sfidat kryesore për realizimin e suksesshëm të reformës. Diskutimet gjatë takim theksuan rolin kyç të AKPT-së në realizimin e suksesshëm të reformave, mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë, si dhe nevojën për mbështetje nga donatorët.Takimi përfundoi me diskutime midis pjesëmarrësve, të cilët shprehën vullnetin dhe gatishmërinë e tyre për bashkëpunim dhe koordinim të hapave që duhet të ndërmerren, për të garantuar jo vetëm synimin e planeve të përgjithshme territoriale, por gjithashtu edhe zbatimit të tyre në përputhje me legjislacionin dhe interesat publike.

Roli dhe Kompetencat e QARKUT & Instrumentet e tjera te Zhvillimit Rajonal.

Në kuadrin e Programit për Zhvillim Rajonal në Shqipërinë e Veriut, Rudina Toto, Dritan Shutina dhe Besnik Aliaj kanë pregatitur një dokument politik të detajuar ku rishikojnë rolin dhe kompetencat e Qarkut dhe institucioneve të tjera mbështetëse që lidhen me Zhvillimin Rajonal. Dokumenti ka si qëllim të tërheqë vëmëndjen tek sfidat e shumta me të cilat përballen institucionet e zhvillimit rajonal si dhe vetë procesi në Shqipëri, duke detajuar ndryshimet e nevojshme në politika për tu përballur me këto sfida.



Dokumenti ofron një sfond të detajuar te zhvillimit rajonal në Shqipëri, përfshirë një analizë të kuadrit ligjor dhe strategjik, instrumentave dhe palëve të interesit. Zhvillimi historik, hapsinor dhe social-ekonomik i Zhvillimit Rajonal shpjegohet në dokument, në kontekstin Shqiptar dhe Europian, duke u fokusuar tek territori i Qarkut, Këshillat dhe administrata e Qarkut si një pikë lidhëse dhe institucion për qeverisje rajonale dhe zhvillim rajonal.

Një analizë gjithëpërfshirëse e procesit dhe pritshmërive, duke marrë parasysh prioritetet e Shqipërisë për integrim në BE, deduktohet nga sfidat kryesore me të silat përballet zhvillimi rajonal në Shqipëri. Këto variojnë nga roli ende i papërcaktuar i Qarkut si institucion, tek kuadri i pamjaftueshëm ligjor dhe strategjik për zhvillim rajonal dhe deri tek përpjekjet politike për të përparuar me decentralizimin politik, administrativ dhe fiskal në Shqipëri.

Ndryshimet politike që nevojiten për tu përballur me këto sfida duhet të fokusohen në krijimin e një zhvillimi rajonal më gjithëpërfshirës dhe të integruar. Politika e re duhet të synojë dy objektiva kryesore: (1) Të krijojë kushtet ligjore dhe institucionale për ofrimin e shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe efikase qytetarëve si dhe (2) të nxisë zhvillim rajonal të qëndrueshëm duke forcuar kohezionin socio-ekonomik, rritur konkurueshmërinë ekonomike si dhe duke ndërtuar nje kuadër ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës që i përgjigjet sfidave të zhvillimit kombëtar dhe kërkesave të integrimit në BE.

Politikat e Zhvillimit Territorial







të Bushatit

Sipas ligjit nr. 10119 dt. 23.4.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, të gjitha komunat dhe bashkitë të cilat nuk disponojnë një instrument të kontrollit të zhvillimit të territorit, duhet të pajisen me një të tillë. Në kuadër të ligjit 10119 dhe me ndihmën e Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, Komuna e Bushatit ndërmori, në prill 2012, nismën e hartimit të dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Territorit. Hartimi i këtij dokumenti u mbështetet nga projekti DAAC Phase – Out i financuar nga SIDA, Agjencia Suedeze për Zhvillimin në Tiranë dhe u realizua nga një grup i përbashkët pune i përbërë nga përfaqësues të Komunës Bushat dhe Co-PLAN.

Hartimi i dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Territorit është realizuar përmes një procesi i cili ka përfshirë në çdo hap të tij komunitetin qoftë nëpërmjet takimeve konsultative të realizuara në mjediset e Komunës me përfaqësues të grupeve të interesit, qoftë nëpërmjet pyetsorëve të realizuar në terren nga grupi i përbashkët i punës.

Ky dokument u miratua në Këshillin e Komunës Bushat në tetor 2012. Dokumenti i Politikës së Zhvillimit të Territorit të Komunës Bushat është instrumenti i parë i planifikimit në Shqipëri i hartuar sipas përcaktimeve të ligjit 10119. Ai shërben jo vetëm për të orientuar zhvillimin e ardhshëm territorial, ekonomik, social dhe mjedisor të Komunës, por i hap rrugën hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe rregulloreve përkatëse të planifikimit të territorit.

A Beginner's GUIDE TO ADVOCACY in Albania

Mos e vër kurrë në dyshim që një grup i vogël qytetarësh të kujdesshëm e të angazhuar mund ta ndryshojë botën. Në fakt, është e vetmja gjë që ka mundësuar ndryshimin.

Margaret Mead

Udhëzuesi i Advocacy për Fillestarë është një manual praktik mbi iniciativat e advocacy në politikat publike. Ekspertët e politikave publike në Institutin për zhvillimin e Habitatit Co-PLAN ja drejtojnë këtë udhëzues një audience të gjerë, duke pasur në mëndje si profesionistët ashtu edhe jo profesionistët. Kjo audiencë përfshin think tank, institute kërkimore, OJF, akademikë, shoqata, koalicione apo grupe interesi, por edhe individë, analistë politikë dhe këshilltarë të qeverisë. Pra, cdo individ apo organizatë që dëshiron të influencojë në procesin e politikëbërjes në Shqipëri, mund ta përdorë këtë udhëzues si një hap fillestar drejt ngritjes së një cështjeje për debat publik, ndikmit të një politike aktuale apo drejt bashkimit të forcave me grupe të tjera për të sjellë ndryshim në fushën e tyre të interesit.



Ky udhëzues përbën edhe një hyrje praktike dhe koncize mbi proceset komplekse të krijimit dhe implementimit të politikave publike në Shqipëri dhe mbi mënyrat se si advocacy mund të përdoret për ti influencuar.

Si fillim, udhëzuesi ofron një hyrje në konceptet e advocacy dhe në arenën e politikave publike. Në kapitullin e dytë, një kuadër i thjeshtuar teorik prezanton llojet e ndryshme të politikave publike dhe modelet e ndryshme të advocacy që i përshtaten secilit lloj. Kapitulli i tretë fokusohet tek politikëbërja në Shqipëri dhe shpjegon proceset e saj, si nga konteksti institucional (ekzekutiv dhe legjislativ) ashtu edhe nga konteksti i shoqërisë civile. Pas prezantimit të politikave publike në Shqipëri, aktorëve të përfshirë dhe mjedisit politik, udhëzuesi vijon me mënyrat e ndryshme të zhvillimit të politikave publike. Kapitulli katër prezanton ciklin e politikave, një kuadër konceptual për të kuptuar se si politikat zhvillohen nëpërmjet një modeli hap pas hapi dhe se cilat janë implikimet për advocacy në secilën fazë.


Shembuj dhe raste studimore luajnë një rol të rëndësishëm në këtë udhëzues. Skenarë dhe qasje të ndryshme ilustrohen me iniciativa nga arenat Shqiptare dhe nërkombëtare të politikëbërjes, për tu ofruar lexuesve një përshkrim të përpjekjeve që zakonisht nevojiten për të arritur infuencimin e politikave.

Shpresojmë që think tanke, organizata të shoqërisë civile, qëndra kërkimore si dhe individë e grupe vullnetare do të mund ta përdorin këtë udhëzues si një hap fillestar në advocacy-n politik. Nëpërmjet përpjekjeve për të ushtruar ndikim në politikëbërje, advokatët u shërbejnë gjithashtu interesave të tyre duke ndihmuar njëkohësisht përfshirjen aktive të shoqërisë civile Shqiptare në vendimet që rregullojnë jetën publike.

Instituti për zhvillimin e Habitatit Co-PLAN ka si qëllim të përmirësojë sasinë dhe cilësinë e punës kërkimore në fushën e politikëbërjes dhe të rrisë impaktin mbi politika të ndryshme në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. Udhëzuesi i Advocacy për Fillestarë është i pari në një sërë iniciativash dhe publikimesh nga Co-PLAN, për të ndjekur këtë objektiv dhe për të kontribuar në një ambjent më demokratik dhe përfshirës në politikëbërjen Shqiptare.

MBI DECENTRALIZIMIN FISKAL

Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri (PLGP) - financuar nga USAID - prezantoi një Dokument Politikash mbi Decentralizimin Fiskal në Shqipëri.



burimi: Siti zyrtar i PLGP

Rekomandime

! VEPRIME TW MENJWHERSHME !

1. Rishikim dhe përditësim i Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit.
2. Kompletimi i Draft Ligjit për Financat Publike;
3. Sinkronizimi i të dhënave të censusit dhe rregjistrit të të dhënave civile'
4. Përfundimi i procesit të kalimit të pronave publike tek NJQV-të.
5. Shpërndarje më e mirë taksës së mjeteve motorrike duke i kaluar NJQV-ve një pjesë më të madhe.

! VEPRIME AFATGJATA !

1. Rishikimi i strukturave administrative të territorit pas një periudhe strukturimi vullnetar, I ndjekur më pas nga një shkrirje (kombinim) i detyruar.
2. Transferimi tek NJQV-të i funksioneve të përbashkëta (të ndara) sipas vullnetit dhe kapacitetit të njësisë.
3. Ndarja e taksave mbi të ardhurat personale sapo problemet teknike të lidhura me zbatimin të jenë zgjidhur; dhe
4. Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësive të rajoneve (Qark-ut)

Në një përpjekje të vazhdueshme për të përkrahur decentralizimin fiskal në Shqipëri, Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri (PLGP)i financuar nga USAID paraqiti një dokument politikash mbi Decentralizimin Fiskal në Shqipëri duke u përqendruar veçanërisht në gjendjen e procesit aktualisht, dhe se çfarë mund të bëhet më tej për sa i takon politikë-bërjes? Më konkretisht, dokumenti i politikave, i cili u hartua nga ekspertë në nivel kombëtar e ndërkombëtar ku dhanë kontribut në punë parapregatitore dhe hartim të dokumentit dhe ekspertë të Co-PLAN, është konceptuar më tepër si një instrument për të nisur dialogun mes palëve të interesuara, sesa si një dokument, duke u përqendruar në katër fusha kryesore: (1) korniza ligjore, (2) struktura administrative territoriale dhe ndarja e shpenzimeve, (3) të ardhurat dhe transfertat ndërqeveritare, dhe (4) huamarrja vendore. Gjetjet e këtij dokumenti politikash të cilat mund të shkarkohen nga faqja zyrtare PLGP-së, u diskutuan gjerësisht me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe me shoqatat kombëtare lokale dhe komunitetin e donatorëve. Komentet dhe propozimet e marra janë përfshirë në draftin final të dokumentit të politikave, i cili u finalizua në shtator të vitit 2012 dhe u diskutua në Konferencën e Decentralizimit Fiskal mbajtur në fillim të tetorit të vitit 2012. Duke u bazuar në gjetjet e dokumentit, dhe të objektivit të përgjithshëm, më 4 tetor 2013 u mbajt një Konferencë mbi Decentralizimin Fiskal në Shqipëri, një aktivitet i nivelit të lartë i cili u ndoq nga Kryeministri i Shqipërisë Z. Sali Berisha, Ambasadori Amerikan Z. Alexander Arvizu, Kryetarët e NJQV-vë partnere të PLGP-së, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Financave, komunitetit të donatorëve që punojnë në qeverisjen vendore dhe OJQ-të. Njësitë vendore 'partnere të PLGP-së njësi të qeverisjes vendore përfshijnë: Tiranën, Durrësin, Fierin, Lushnjen, Beratin, Kuçovën, Patosin, Vlorën, Sarandën, Elbasanin, Korçën, Vorën, Kamzën dhe komunat e Kasharit dhe Paskuqanit.

JAVËT E ARKITEKTURËS NË TIRANË

Sikurse pritej që nga viti 2011, Javët e Arkitekturës në Tiranë shënoi dhe pikën kulmore të kalendarit të aktiviteteve të U_POLIS për vitin 2012, për nga dimensioni i saj ndërkombëtar dhe intensiteti i aktiviteteve të organizuara si dhe njohurivë të shkëmbyera. Gjatë muajëve shtator-tetor 2012, Tirana u shndërrua në një mikëpritëse e denjë e ekspertëve ndërkombëtarë, profesionistëve të fushës së arkitekturës, planifikimit urban, e dizajnit, duke e kthyer qytetin në një shfaqje të gjallë për performancat dhe aktivitet e planifikuar, si pjesë e katër blloqeve përbërës së Javëve të Arkitekturës në Tiranë, përkatësisht: Arkitekturë, Art & Dizajn, Aktivitete Publike, dhe Seminarë ndërkombëtarë.

Qëllimi i Javëve të Arkitekturës në Tiranë ishte të promovonte shkëmbim ndërkombëtar të njohurive mes profesionistëve dhe rritja e interesit public në arkitekturë, art e dizajn, si dhe disiplina të lidhura ngushtë me zhvillimet bashkëkohorë të qytetit.


AKTIVITETE ARKITEKTURE

Swiss Positions: 33 qasje të ndërtimit të qëndrueshëm – një ekspozitë lëvizëse, koleksion i 33 projekteve kyç nga industria e ndërtimit në Zvicër nga njëzet vitet e shkuara, të cilat kishin të përbashkët temën e zhvillimit të qëndrueshëm. Arkitektura dhe inxhinjeria zviceriane gëzojnë një reputacion të shkëlqyer dhe vizibilitet të lartë jo vetëm për nga cilësia e ekspertizës teknike dhe dizajni tërheqës, por dhe për nga integrimi i elementëve të përparuar të zhvillimit të qëndrueshëm.









Stacioni Multimodal i Tiranës – Një promovim publik i ideve të cilat u zhvilluan dhe u shfaqën me synimin për të identifikua idetë më krijuese, si pjesë e konkursit për Stacionin Multimodal të Tiranës. Dy aktivitete të zhvilluar njëkohësisht me konkursin u krijuan mundësinë qytetarëve të marrin pjesë dhe të ri-kthejnë hapësirën publike. Në ditën e hapjes u organizua një koncert jazz-i I një grupi muzikor bashkëkohor, dhe në ditët pasuese u organizua shfaqja e një filmi shqipëtar, Binarët – nga Fejzo Muharrem, 1987) që prekte rëndësinë e hekurudhës në jetën e përditëshme të qytetarëve.

STACIONI ME SHISHE PLASTIKE

U përurua gjatë Javëve të Arkitekturës në Tiranë, më 8 tetor 2012 struktura e parë me shishe plastike të ricikluara në Shqipëri, e cila do të shërbejë si një stacion autobuzi në Komunën e Kasharit. Stacioni i autobuzit me shishe, i cili është i vendosur në afërsi të Universitetit Polis, është i përbërë nga 12.000 shishe plastike (0.5l) të cilat u mblodhën nga konsumi i brendshëm në mjediset e U_POLIS si dhe vullnetarë të jashtëm. Ky projekt, origjinal në mënyrën e tij, për të ricikluar shishe plastike uji, synon të promovojë një ide unike dhe efikase në hartimin dhe riciklimin, midis komunave dhe bashkive të Shqipërisë.







HISTORIA E NJË APARTAMENTI

Historia e një apartamenti - Katër tregime për katër apartamente në Tiranë, dy nga periudha komuniste, 1950-1990 's dhe dy të ndërtuar pas viteve 1990. Këto apartamente ishin në qendër të një ekspozite të organizuar në ambientet e U_POLIS , duke shfaqur dhe analizuar ndryshimet funksionale, si kanë ndikuar në cilësinë e jetës së përdoruesve dhe si ata janë të lidhur me kushtet e përgjithshme në shoqëri në atë periudhë. Kjo ekspozitë është pjesë e një hulumtimi më të gjerë: "Cilësia e jetës ndryshon cilësinë e hapësirës", kryer në bashkëpunim me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, përmes projektit të studimeve kërkimore me temë "Tipologjia e Strehimit shqiptar në Kontekstin e tij Ballkanik ".

Aktivitete
ART & DIZAJN

SHESHE ME JETË

Gjatë Javëve të Arkitekturës në Tiranë, u Zhvillua një konferencë katër-ditore mbi " Ripërvetësimin e Qytetit , e organizuar nga Co-PLAN në bashkëpunim me Universitetin POLIS, EXPEDITIO dhe Kor-CSD.Konferenca u përqëndrua në transformimin e Shesheve të qytetit në vende të reja për komunitetin si një nga ngjarjet kryesore të Javës së Arkitektures në Tiranë.

The Pythagoras' (un)constant (Ekspozitë) lindi si një inspirim nga projekti 'Rilindja e Shesheve në Qytete Ballkanike', qëllimi i të cilit është të reflektojë në ide të reja dhe krijuese në lidhje me sheshet dhe mënyrën se si njerëzit i përdorin këto sheshe.



DINAMIKA SPIRALE & QYTETI

Dinamikat Spirale dhe Qyteti: Si vlerat i japin formë Ambjentit Urban" pregatitur nga Peter Nientied dhe Rudina Toto

Në kuadrin e Javës së Arkitekturës në Tiranë (TAW: Tirana Architecture Week), 8-12 Tetor 2012, u prezantua studimi "Dinamikat Spirale dhe Qyteti: Si vlerat i japin formë Ambjentit Urban" pregatitur nga Peter Nientied dhe Rudina Toto.

Studimi u mor me dilemën aktuale të arkitekturës bashkëkohore dhe shkollave të mendimit të planifikimit: si ti bëjmë qytetet të jetueshme. Duke bërë këtë, studimi hedh dritë edhe mbi shumë sfida si: nevoja për përcaktim më të mirë të problemeve që lidhen me ambjentin urban, nevoja për metoda që mund të diagnostikojnë problemet kryesore në qytet, identifikimi i veprimeve të ndryshme që mund të ndërmerren në një qytet gjithmonë në ndryshim si dhe nevoja për qasje të reja që sjellin ndryshime efikase. Për tu përballur me këto sfida duhet, pikë së pari, një model që do të ndihmonte në kuptimin dhe adresimin e tyre.

Studimi në fjalë ofron modelin e Dinamikave Spirale si vegël për diagnostikimin e evolucionit të qytetit dhe diseksionin e marrdhënieve komplekse ndërmjet qytetit dhe banorëve të tij. Ky model ndjek ndryshimet në sistemet e vlerave për të kuptuar tendencat dominuese në cdo shoqëri dhe për të zhvilluar një kuptim më thelbësor të qytetit në drejtimin fizik dhe socio-kulturor. Ilustrime të shprehjeve fizike të Dinamikave Spirale janë marrë nga dy shembuj konkretë në qytetin e Roterdamit në Hollandë si dhe një rast studimor i thelluar mbi Tiranën.

Modeli i Dinamikave Spirale është përdorur për të shpjeguar dhe për ti dhënë drejtim lëvizjeve dhe veprimtarive efektive që synojnë ta kthejnë qytetin në një ambjent të jetueshëm. Në kuadrin e temës së TAW – [Ri]Përvetësimi i Qytetit – studimi ka për qëllim të zbulojë cfarë duhet bërë për ta ripërvetësuar hapsirën publike në Tiranë, dhe ofron kthimin e vlerave kolektive qytetit si një zgjidhje e mundshme.


THE_PYRAMID








DRIVERS_PEDESTRIANS


TIRANA_BEFORE '90s








BUILDING_BLOCKS




PLANS&REALITY SHOPPING_MALLS


COMMUNITY&GARDEN

BED&BUNKER

http://bunkerkunft.fh-mainz.de/

Një projekt bashkëpunimi ndërkombëtar mes studentëve të FH Mainz, nga Universiteti I Shkencave të Aplikuara (Gjermani), dhe Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtar e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit, (Tiranë, Shqipëri).



Ky projekt u frymëzua nga teza e diplomës së një studenteje shqipëtare në FH Mainz – Arkitekturë Interiori, e cila ka lindur dhe është rritur në Tiranë.
Nisur nga pamjet e shpeshta të bunkerizimit të hapësirave urbane dhe rurale, studentja pati idenë për t'i përshtatur këto struktura për përdorim turizimi individual. Projekti synoi që të rindërtonte struktura strehimi rezistente ndaj ujit, për turistë, pa ndryshime radikale mbi bunkerin, si një alternativë e mirë e tendave të kampingut.

Në vitet '70-'80, qindra mijëra bunkerë të llojeve të ndryshme u ndërtuan në Shqipëri për qëllime mbrojtjeje të vendit nga agresione të huaja. Por këto të fundit, pavarësisht frikës së madhe, nuk ndodhën asnjëherë, ndaj dhe bunkerët nuk u përdorën për qëllimin e tyre fillestar. Sot, bunkerët, kryesisht të rrumbullakët, gdhendin relieving nga malet deri në vijën bregdetare, në pozicione kyçe dhe fushëpamje të lartë. Projekti u fokusua në një bunker përgjatë vijës bregdetare (Tale, Lezhë), I cili është lehtësisht I aksesueshëm me makinë, në këmbë ose me biçikletë. Aktualisht, numërohen rreth 400, 000 bunkerë, duke përfshirë të gjitha llojet e bunkerëve, mbi tokë, nën tokë, të vegjël e të mëdhenj.












Fashion nuk eshte neutral: Tema e këtij 'fashion show' ishte 'Fashion Surealist' duke përdorur materiale të ricikluesme, por jo vetëm. Studentët, të cilët kanë një njohje të mirë të elementëve surrealist, e përqafuan lehtësisht konceptin e shfaqjes, dhe krijuan 15 veshje të asistuar në proces dhe nga një rrobaqepës profesionist.

Aktivitete Publike



Trans[a]cting the city, një numër turesh të improvizuar në qytet synoi të promovonte eksperiencat sociale dhe profesionale me qëllim zbulimin e itinerareve alternativë dhe jotradicionalë të qytetit. Të hapura për të gjithë, shumëngjyrësh dhe I pasur në ndërveprim social për nga qasja, ky aktivitet shërbeu si një injeksion vitaliteti në qytet me anë të performancave të ndryshme me qëllim ri-aktivizimin e hapësirave publike në Tiranë.

Tirana Urban Bundles (TUB), një hapësirë e përbashkët e cila ofron kushte pjesëmarrje dhe përfshirje për njerëzit në procesin e krijimit dhe manaxhimit të mjedisit të tyre urban. TUB është gjithashtu një instrument politik I njerëzve të cilët përpiqen të ndikojnë zhvillimin e marrëdhënieve mes jetës publike e private në qytet. Në rastin e Tiranës, Urban Bundle ishte një instalacion I përkohshëm në hapësirë publike për të lehtësuar takimet, mbledhjet e administratorëve, qytetarëve, dhe ekspertëve me qëllim që të mbajnë të hapur diskutimin për zhvillimin e kushteve urbane të



Ndër[veprimi] Urban u përqendrua në ato hapësira të veçanta të cilat përbëjnë dhe imazhin urban, por që megjithatë I shpëtojnë shikimit. Ky aktivitet erdhi si një ri-krijim ndërveprues i një mjedisi public ekzistues, duke stimuluar shndërrimin e këtyre zonave urbane në fillesa të një vizioni të ri të qytetit. Në qendër të pritshmërive nga ky aktivitet, ishte vlerësimi i zonave ekzistuese të qytetit si sisteme të jetueshme urbane.

Loja e Qytetit - një ndërtim strategjik dhe kufizur në kohë I cili filloi me ndarjen e roleve the prezantimin e problematikës imagjinare (ose të vërtetë) të qytetit. Loja u luajt në periudha të përcaktuara kohore, ku çdo orë që kalonte përfaqësonte një periudhë më të gjatë kohore (psh. një vit). Në këtë mënyrë, vëzhguesit mund të ndiqnin zhvillimet në qytet çdo orë që kalonte. Njohuria teknike në fusha të ndryshme përbëntë një kusht paraprak për çdo lojtar të kësaj loje, ndonëse qytetarët vëzhgues ishin në gjendje të kuptonin rezultatet dhe t'I lidhnin ato me situata reale në qytet.






WORKSHOPE

Workshop Diagonal

U përqendruan në marrëdhëniet ndërlidhëse mes artit, dizajnit dhe arkitekturës. Ëorkshopet ofruan një mundësi për të punuar me fotografinë, dizajnin, dhe arkitekturën përmes një pikëpamjeje eksperimentale. Në mënyrë që të përfshihesh në një eksperiencë, krijimtaria është aftësia e vetme që duhet të synosh të zhvillosh.






Workshop Vertikal

Qyteti si një fenomen përgjatë dimensionit vertikal

Workshopi vertikal u fokusua në shtresat vertikale të qytetit të Tiranës si dhe rrethinat e tij. Përmes ëorkshopit, u prezantua shprehja 'shtresë vertikale' për të theksuar konceptin e 'qytetit' si një fenomen i mbledhjes dhe lulëzimit të materialeve fizike përgjatë dimensionit vertikal. Shpërhapja vertikale e funksioneve në Tiranë përbëntë dhe temën kryesore të ëorkshopit, I cili I konsideroi hapësirat si katalizatorë për eksplorimin dhe ri-lindjen e kushteve specifike urbane dhe arkitektonike.



Workshop Horizontal: Lumi i 'Tiranës' si një shenjë e strukturimit horizontal të qytetit

Ky workshop u fokusua në lumin e Tiranës, si një përzierje komplekse dhe heterogjene e realiteteve, dhe një shenjë domethënëse e strukturimit horizontal të qytetit. Ëorkshopi konsistoi në disa leksione, vëzhgime të drejtpërdrejta në terren, të pasuara nga disa mikro-transformime si veprime urbane frymëzuese. Ky ëorkshop synoi të rriste ndërgjegjësimin në lidhje me lumin e Tiranës, si dhe të vërë në pah potencialet e ardhëshme të këtij elementi në kornizën më të madhe qytetare.